

L I G J
Nr.9178, datë 29.1.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË RISHITJES SË AKSIONEVE TË INSIG SHA-SË, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR, KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFC) DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e rishitjes së aksioneve të INSIG sha-së, ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, Koorporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4137, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

E RISHITJES SË AKSIONEVE TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHA, NDËRMJET BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, KORPORATËS NDËRKOMBËTARE FINANCIARE DHE MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR

Kjo Marrëveshje nënshkruhet më ____ shtator 2003, ndërmjet:

1. Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim (EBRD);
2. Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC);
3. Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, pronare e aksioneve në Shoqërinë Instituti i Sigurimeve sh.a., sipas ligjit nr.8831, i shpallur më 22.11.2001 "Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror", përfaqësuar nga Ministri i Financave (Ministria).

Hyrje

- A) Instituti i Sigurimeve sh.a. është shoqëri anonime e themeluar sipas legjislacionit shqiptar

dhe e regjistruar me vendimin nr.21463, datë 8.6.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës (Shoqëria).

B) Në datën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, kapitali aksionar i regjistruar i Shoqërisë është 1700 aksione të zakonshme, me vlerë nominale secili 1 000 000 lekë (aksionet), të gjitha të regjistruara në emër të Ministrisë si pronare e vetme.

C) Më datë.....2003 Ministria, IFC-ja dhe EBRD-ja lidhin një Marrëveshje (Marrëveshje për shitje aksionesh), sipas së cilës Ministria do t'i shesë 332 aksione EBRD-së (aksionet e EBRD-së), që përfaqësojnë afro 19.5 për qind të të gjithë kapitalit aksionar të Shoqërisë dhe do t'i shesë IFC-së 332 aksione, që përfaqësojnë afërsisht 19.5 për qind të të gjithë kapitalit aksionar të Shoqërisë (aksionet e IFC-së).

D) Një ndër kushtet e Marrëveshjes së shitjes së aksioneve është që Ministria, EBRD dhe IFC (së bashku: Palët) hyjnë në këtë Marrëveshje (Marrëveshja për rishitjen e aksioneve), e cila parashikon të drejtën e EBRD-së dhe të drejtën e IFC-së t'ia rishesin Ministrisë aksionet e blera, sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e mëposhtme (Marrëveshja për rishitjen e aksioneve).

Palët arritën në këtë Marrëveshje me kushtet vijuese:

1. INTERPRETIMI I TERMAVE

1.1 Termat e mëposhtëm që do të përdoren në këtë Marrëveshje rishitje do të kenë kuptimin që u jepet në këtë Marrëveshje rishitje përveç rasteve kur palët u japin kuptim tjetër këtu ose kur nga përmbajtja rezulton ndryshe:

"Kostoja e përbërë" është kostoja e secilit blerës në dollarë, shtuar interesat e barabarta me shumën e kursit ndërbankar (për secilën nga periudhat përbërëse), plus kufijtë e rishitjes, duke përfshirë datën e transfertës, por duke përjashtuar datën e pagesës. Këto interesa do të llogariten në bazë të numrit aktual të ditëve të kaluara dhe të vitit me 360 ditë dhe do të llogariten në fund të secilës periudhë të përbërë.

"Dividendët e përbërë" është shuma në dollarë amerikanë e marrë nga secili blerës me fonde menjëherë të disponueshme, si të ardhura nga konvertimi në të holla i dividendëve të pagueshëm apo nga aksionet përkatëse të secilit blerës, para ose pas datës së pagesës, plus interesin e barabartë me kursin ndërbankar (për secilin nga periudhat e përbëra), shtuar kufijtë e rishitjes nga data ose datat e marrjes nga blerësit në ditën e pagës. Këto interesa do të llogariten në bazë të numrit konkret të ditëve të kaluara dhe një viti me 360 ditë dhe do të llogariten në fund të secilës periudhë të përbërë.

"Data e përbërë" është:

a) Kur bëhet fjalë për çdo aksion që do të transferohet sipas kësaj Marrëveshjeje rishitje dhe përlllogaritjes së kufizimit të përgjegjësisë të parashikuar në nenin 10.1:

- i) data e transferimit;
 - ii) data që bie 6 muaj pas kësaj date;
 - iii) çdo përvjetor i datave të parashikuara në paragrafët (i) dhe (ii) më sipër;
- b) Kur bëhet fjalë për dividendët e përbërë:
- i) dita e pagesës së këtyre dividendëve;
 - ii) data që bie 6 muaj pas kësaj date pagese;
 - iii) çdo përvjetor i datave të përcaktuara në paragrafët (i) dhe (ii) më sipër.

c) Kur bëhet fjalë për interesa mbi shuma të papaguara:

- i) data e detyrimit të pagimit të shumave të prapambetura;
- ii) data që bie 6 muaj pas kësaj date pagese;
- iii) çdo përvjetor i datave të përcaktuara në paragrafët (i) dhe (ii) më sipër, me kusht që në rast se ndonjëra prej këtyre datave nuk do të jetë ditë-pune, atëherë data e përbërë do të jetë data e parë pas kësaj që është ditë-pune.

"Periudhë e përbërë" do të thotë çdo periudhë 6-mujore, që fillon në një datë të përbërë duke e përfshirë atë, deri në datën e përbërë pasuese, por duke, përjashtuar atë, përveç periudhës së fundit të përbërë, e cila do të shtrihet deri në datën e kryerjes së pagesës përkatëse, por duke përjashtuar këtë datë.

"Dëmi" është shuma në dollarë amerikanë (dhe, kur paguhet ose është për t'u paguar në ndonjë monedhë tjetër, shuma e dollarëve amerikanë e përftuar nga këmbimi brenda vendit i monedhës tjetër me kursin e këmbimit në fuqi në datën e kryerjes së pagesës, sipas përcaktimit të arsyeshëm të blerësve), e cila përcaktohet ose pranohet si e pagueshme nga Ministria ndaj njërit ose të dy blerësve

për shkelje të ndonjë prej deklarimeve, zotimeve, garancive ose detyrimeve në ndonjërin prej dokumenteve të projektit.

"Rasti i mospërbushjes së detyrimit të riblerjes së aksioneve" përkufizohet në seksionin 6.

"Periudha e ushtrimit të rishitjes për shkak mospërbushjeje" është periudha që fillon në datën e transferimit dhe mbaron në datën që përkon me 5-vjetorin e datës së transferimit.

"Data e njoftimit" është data në të cilën blerësit i dërgojnë Ministrisë njoftimin për rishitje.

"Aksionet e EBRD-së" përkufizohen në pikën C të hyrjes.

"Ngjarja si shkak për daljen" është ajo që përkufizohet në seksionin 7.

"Organ qeveritar" është:

- a) çdo vend, rajon, shtet, qark, qytet, fshat, rreth ose juridiksion tjetër;
- b) çdo qeveri federale, shtetërore lokale, bashkiake, të huaj ose tjetër;
- c) çdo autoritet qeveritar ose i ngjashëm me të (përfshirë agjenci qeveritare, degë, drejtori ose organ tjetër dhe gjykatë ose organ arbitrazhi);
- d) çdo organizatë shumëkombëshe;
- e) çdo organ që ushtron ose ka të drejtë të ushtrojë kompetenca administrative ekzekutive, gjyqësore, legjislative, politike, rregullatore ose tatimore ose kompetenca të çfarëdolloj natyre;
- f) çdo subjekt shtetëror;
- g) çdo punonjës të ndonjërit prej subjekteve të mësipërme.

"Aksionet e IFC-së" janë ato që përkufizohen në pikën C të hyrjes.

"Kërkesa të ligjit" janë kushtetutat, ligjet, dekretet, traktatet, rregullat, rregulloret, udhëzimet, vendimet detyruese gjyqësore për çështjet eaktuara ose parimet e së drejtës, njoftimet, miratimet ose urdhrat e organeve qeveritare.

"Palët" janë ato që përkufizohen në pjesën hyrëse D.

"Procedurë" është çdo padi, arbitrazh, kontroll, shqyrtim, hetim, seancë gjyqësore, proces gjyqësor ose padi (si civil, penal, administrativ, gjyqësor, ashtu edhe hetimor, zyrtar ose jozyrtar, publik ose privat) që fillohet, ngrihet, drejtohet ose dëgjohet përpara ose që në ndonjë mënyrë tjetër kërkon pjesëmarrjen e ndonjë organi qeveritar ose arbitri.

"Blerësit" janë EBRD dhe IFC ose trashëgimtarët e tyre ose personat të cilëve ata u kanë transferuar këtë Marrëveshje.

"Kostoja e blerësit" është vlera në dollarë e çmimit fillestar të shitjes i përshtatur sipas Marrëveshjes së shitjes së aksioneve, që blerësi përkatës ka paguar për blerjen e aksioneve bashkë me (subjekt i një shume maksimale prej pesëdhjetë mijë dollarësh amerikanë) çdo kosto transaksioni të paguar nga blerësi përkatës në kuadrin e blerjes së aksioneve, të cilat nuk janë rimbursuar sipas pagesave të përshkruara në seksionin 6.16 të Marrëveshjes për blerjen e aksioneve.

"Ngjarja që sjell rishitjen" është ngjarja sipas së cilës kryhet rishitja për mospërbushje ose ngjarja e daljes të secilit blerës nga Shoqëria.

"Kufiri i rishitjes" është:

- a) në rastin e rishitjes për mospërbushje, katër pikë pesë për qind (4.5%) në vit;
- b) në rastin e rishitjes për daljen, tre për qind (3%) në vit.

"Njoftimi i rishitjes" është njoftimi që një blerës i bën Ministrisë për ushtrimin e së drejtës së rishitjes sipas nenit 6 ose nenit 7, i cili duhet të përcaktojë, të paktën:

- a) numrin e aksioneve që secili blerës do t'i rishesë Ministrisë;
- b) çmimin e rishitjes, në masën që është e mundshme të llogaritet ky çmim në datën e njoftimit për rishitje (përfshirë hollësitë e kësaj përlllogaritjeje);
- c) datën e pagesës;
- d) vendin e pagesës;
- e) të dhënat e llogarive bankare ku do të paguhet çmimi i rishitjes.

"Periudha e rishitjes" është periudha që fillon në datën e transferimit dhe mbaron në përvjetorin e dytë të kësaj date.

"Çmimi i rishitjes" është çmimi për aksion i barabartë me shumën, të shprehur në dollarë amerikanë, që përftohet pjestimi i shumës që rezulton nga zbritja e dividendëve të përbërë prej kostonë së përbërë me numrin total të aksioneve të EBRD-së dhe të IFC-së, blerë nga secili blerës sipas Marrëveshjes së shitjes së aksioneve.

"Data e pagesës" është data e specifikuar në njoftimin për rishitje si datë për kryerjen e shitjes dhe blerjes së aksioneve nga Ministria në përputhje me dispozitat e nenit 8.1, 8.2 dhe 8.3, e cila do të

jetë ditë-pune jo më shumë se 45 dhe jo më pak se 14 ditë pas datës së dhënies së njoftimit për rishitje, me kusht që çdo çështje lidhur me ndodhjen e rastit për rishitje ose me llogaritjen e çmimit të rishitjes të jetë paraqitur në arbitrazh ose gjykatë sipas nenit 14.2 dhe procedurat përkatëse të këtyre organeve të kenë filluar në ose para datës së caktuar në këtë mënyrë, atëherë si datë e pagesës do të konsiderohet dita e pestë e punës pas datës më të parë në të cilën:

- a) mosmarrëveshja është zgjidhur me pajtim;
- b) palët kanë hequr dorë nga gjykimi; ose
- c) gjykata ose arbitrazhi kanë dhënë vendim të formës së prerë për çështjen.

"Vendi i pagesës" është vendi i caktuar në njoftimin përkatës për rishitje për kryerjen e shitjes dhe blerjen e aksioneve nga blerësi përkatës në përputhje me kushtet e neneve 8.1, 8.2 dhe 8.3.

"Marrëveshja e shitjes së aksioneve" është ajo që përkufizohet në hyrje shkronja C.

"Aksionet" janë përkufizuar në hyrje shkronja B.

1.2 Kjo Marrëveshje rishitje ose çdo dokument tjetër, kontratë ose marrëveshje që u bëhet referim në të do të përmbajnë një referim sipas së cilës lejohet të shtohet ose ndryshohet kjo Marrëveshje rishitje dhe dokumenti ose kontrata që ndryshohet ose shtohet herë pas here, përjashtuar ndryshimet, shtesat, zëvendësimet ose shtesat e bëra në shkelje të kësaj Marrëveshjeje rishitje.

1.3 Kur përmendet termi Marrëveshje rishitje, në të përfshihet edhe pjesa hyrëse e saj.

1.4 Çdo ligj, dekret ose dispozitë ligjore do të përfshijë (me përjashtim të rasteve kur përcaktohet nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim ligjor ose jo) çdo ligj, dekret ose dispozitë ligjore që ndryshon, zëvendëson ose ka ndryshuar, ose ka zëvendësuar atë të mëparshmin dhe do të përfshijë çdo akt nënligjor (duke përfshirë, por pa u kufizuar në çdo udhëzim apo vendim të subjekteve shtetërore) të bërë sipas këtyre ligjeve, dekreteve ose dispozitave ligjore.

1.5 Një pjesë hyrëse ose nen i veçantë do të trajtohet si referencë e asaj pjese hyrëse ose neni të veçantë të kësaj Marrëveshjeje rishitje.

1.6 Titujt dhe tabela e lëndës janë vendosur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje rishitje.

1.7 Në këtë Marrëveshje rishitje numri njëjës përfshin shumësin dhe anasjelltas.

2. KUSHTI PARAPRAK

Detyrimet e Ministrisë sipas kësaj Marrëveshjeje rishitje kushtëzohen nga blerja prej EBRD-së të Aksioneve të EBRD-së e të aksioneve e IFC-së nga IFC-ja në përputhje me Marrëveshjen e shitjes së aksioneve.

3. DEKLARIMET E MINISTRISË

3.1 Ministria e deklaron se ka tagër dhe kompetencë për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe që, pas miratimit nga Kuvendi të kësaj Marrëveshjeje rishitje dhe botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshje rishitje, ka tagër të plotë për ta zbatuar këtë Marrëveshje rishitje.

3.2 Ministria deklaron dhe garanton se nuk do të vendoset asnjë taksë pulle, tatime ose detyrime të tjera nga organet tatimore shqiptare për lidhjen, dorëzimin ose zbatimin e Marrëveshjes për rishitje apo çdo transaksion tjetër në lidhje me të për të garantuar ligjshmërinë, vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose pranueshmërinë e saj si provë në gjykatat e Shqipërisë.

3.3 Ministria deklaron dhe garanton se me miratimin e kësaj Marrëveshjeje rishitje nga Kuvendi dhe 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit përkatës që e miraton atë dhe me nënshkrimin e saj nga palët e tjera dhe dorëzimin e saj, kjo Marrëveshjeje rishitje hyn në fuqi dhe përmban detyrime të vlefshme dhe ligjërisht të pashmangshme e të zbatueshme për Ministrinë në përputhje me kushtet e saj dhe se ajo:

a) nuk vjen në kundërshtim me asnjë dispozitë të ligjeve të tjera të zbatueshme për Ministrinë, Shoqërinë ose shtetin shqiptar ose me ndonjë traktat ndërkombëtar të zbatueshëm nga Ministria ose shteti shqiptar;

b) nuk vjen në kundërshtim me dispozita të marrëveshjeve ose instrumenteve ku Ministria, Shoqëria ose shteti shqiptar është palë ose me të cilat lidhen aktive të saj dhe se lidhja e saj nuk kërkon ndonjë miratim sipas atyre marrëveshjeve dhe as nuk krijon ndonjë barrë sipas tyre;

c) nuk sjell mospërmbushje ose ngjarje sipas së cilës, pas dhënies së njoftimit, kalimi i kohës ose marrja e një vendimi ose kombinimi i tyre do të sillte mospërmbushje të kushteve të marrëveshjes ose instrumentit ndërkombëtar.

3.4 Ministria e Financave deklaron dhe garanton se për nënshkrimin, dorëzimin ose zbatimin nga Ministria ose hyrjen në fuqi dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje rishitje, nuk kërkohet gjë

tjetër përveç miratimit të kësaj Marrëveshjeje rishitje nga Kuvendi i Shqipërisë dhe botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshje rishitje.

4. DEKLARIMET E BLERËSVE

Secili prej blerësve deklaron dhe garanton Ministrinë dhe blerësin tjetër, në datën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje rishitje, se:

4.1 ka tagër dhe kompetenca për të lidhur këtë Marrëveshje rishitje dhe për ta zbatuar atë në praktikë;

4.2 nuk kërkohet asnjë autorizim për lidhjen, njoftimin dhe zbatimin prej tij të kësaj Marrëveshjeje rishitje;

4.3 kjo Marrëveshje rishitje përmban detyrime të vlefshme dhe ligjërishit detyruese për blerësin dhe se lidhja e kësaj Marrëveshjeje rishitje dhe zbatimin e kushteve të saj:

a) nuk vjen në kundërshtim me asnjë dispozitë të ligjeve të zbatueshme për blerësin dhe as me ndonjë traktat ndërkombëtar të zbatueshëm për atë blerës;

b) nuk vjen në kundërshtim me dispozita të marrëveshjeve ose instrumenteve ku blerësi është palë ose me të cilat lidhen aktive të tij dhe se lidhja e saj nuk kërkon ndonjë miratim sipas atyre marrëveshjeve dhe as nuk krijon ndonjë barrë sipas tyre;

c) nuk sjell mospërmbushje ose ngjarje sipas së cilës, pas dhënies së njoftimit, kalimi i kohës ose marrja e një vendimi ose kombinimi i tyre do të sillte mospërmbushje të kushteve të marrëveshjes ose instrumentit ndërkombëtar.

5. HEQJA DORË NGA IMUNITETI I SOVRANITETIT

Ministria (në masën më të plotë të lejuar nga ligji i zbatueshëm), pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme:

a) pranon se lidhja, njoftimi dhe zbatimi prej saj i kësaj Marrëveshjeje rishitje janë akte tregtare dhe private;

b) heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ka ajo ose aktivet e saj tani ose që mund të fitojnë nga procedura ligjore të ngritura kundër saj ose aktiveve të saj në lidhje me këtë Marrëveshje rishitje, pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje rishitje, prej blerësit dhe/ose personave të cilëve ata u kanë kaluar të drejtat;

c) pranon se nuk do të përdorë asnjë imunitet të fituar nga këto procedura (që konsiderohen se përfshijnë, pa kufizim, padi, masa provizore para gjykimit ose vendime të tjera të ndërmjetme, vendime, veprime përmbartimore ose ekzekutime të tjera) vetë ose në emër të saj, ose në lidhje me aktivet e saj;

d) në përgjithësi, për këto procedura jep pëlqimin për dhënien e çdo lehtësie ose lëshimin e çdo njoftimi në lidhje me këto procedura, duke përfshirë, por pa u kufizuar në marrjen dhe ekzekutimin e çdo urdhri ose vendimi gjyqësor që mund të jetë dhënë në ato procedura kundër çdo lloj pasurie (pavarësisht nga përdorimi ose qëllimi i përdorimit).

6. RISHITJA PËR MOSPËRMBUSHJE KUSHTESH NGA MINISTRIA

Kur ndodh një ose të gjitha rastet e mëposhtme si:

a) çfarëdo deklaram ose garanci që ka dhënë ose konfirmuar Ministria në ndonjë nga dokumentet e projektit rezultojnë të jetë të pasaktë, të rremë ose çorientues në ndonjë drejtim thelbësor;

b) një vendim i formës së prerë i ndonjë subjekti shtetëror (përfshirë, por pa u kufizuar në, ndryshimet në ligj), të ndryshëm nga një vendim siç përshkruhet në nenin 7(b), që rezultojnë nga padi të ngritura nga organe shtetërore dhe shfuqizojnë ose shpall të pavlefshme pjesërisht ose tërësisht ose në ndonjë pjesë thelbësore, si vijon:

i) privatizimin e Shoqërisë ose procedurën në lidhje me privatizimin e saj;

ii) këtë Marrëveshje rishitje, Marrëveshjen e shitjes së aksioneve ose ndonjë dokument tjetër të projektit dhe/ose ndonjë akti tjetër të lidhur me to;

iii) blerjen e interesave ose të titullit të pronësisë së aksioneve nga secili blerës;

c) çdo veprim i ndonjë subjekti shtetëror (ose një sërë veprimesh nga një ose disa subjekte shtetërore), përfshirë, por pa u kufizuar në ndryshimet në ligj) që është diskriminues në efekte dhe me motive politike dhe:

i) bën që Shoqëria, nëpunësit ose punonjësit e saj pengohen të kryejnë tërësisht ose pjesërisht veprimtarinë e Shoqërisë;

ii) bën që një drejtues, nëpunës ose punonjës tjetër i Shoqërisë të marrë vendim që nuk

mbështetet në parimet e shëndosha të biznesit;

iii) do të bënte që ndonjëri prej blerësve të mos mund të gëzonte ose të ushtronte lirisht të drejtat, interesat dhe titullin mbi aksionet në pronësi të tij, përfshirë, por pa u kufizuar në riatdhesimin e dividendëve, të ardhurat nga shitja ose çdo fryt tjetër të aksioneve dhe as të gëzojë ose të ushtrojë të drejtat e parashikuara nga Marrëveshja e shitjes së aksioneve ose ndonjë dokument tjetër të projektit;

d) nëse, me ndonjë veprim të një subjekti shtetëror (ose një sërë veprimesh nga një ose disa subjekte shtetërore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, ndonjë ndryshim ligjor), i cili është kryer për motive politike:

i) i tëri ose një pjesë e ndonjë aktivi të Shoqërisë, ose titull i ndonjë aktivi ose veprimtarie tregtare të Shoqërisë është penalizuar, shtetëzuar, sekuestruar ose shpronësuar në ndonjë mënyrë tjetër;

ii) është marrë ose fituar kontrolli ose mbikëqyrja, ose titulli i tërë aktiveve të Shoqërisë ose në një pjesë të tyre ose e veprimtarisë së Shoqërisë;

iii) janë blerë aksione të Shoqërisë (me përjashtim të atyre që janë blerë në bazë të Marrëveshjes së shitjes së aksioneve ose të ndonjë dokumenti tjetër të projektit), ose është ndërmarrë ndonjë veprim për prishjen e Shoqërisë ose shkrirjen e saj;

iv) është tërhequr, ndryshuar, pezulluar ose ka skaduar ndonjë autorizim që i është dhënë Shoqërisë ose nuk është ndonjë dokument i tillë, duke shkaktuar, drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë, ndalimin, pengimin ose vonimin e Shoqërisë në kryerjen normale të veprimtarisë tregtare ose të ndonjë pale në zbatimin e detyrimeve ose ushtrimin e të drejtave në këtë Marrëveshje rishitje ose dokumenti tjetër të projektit ose në kryerjen e ndonjë veprimtarie të ndërthurur me to;

e) shkelje thelbësore e kushteve të ndonjë dokumenti të projektit nga Ministria,

me kusht që asgjë në këtë Marrëveshje rishitje të mos pengojë ose kufizojë Komisionin e mbikëqyrjes së sigurimeve për të ushtruar funksionet e tij për rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së sigurimit në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe ushtrimi i funksioneve prej komisionit të mbikëqyrjes së sigurimeve nuk do të përbëjë veprime si ato të parashikuara në paragrafët (i) ose (ii) të nenit 6(c) ose të paragrafit (iv) të nenit 6(d):

(secila "Ngjarja e rishitjes për mospërmbyshje")

dhe (i) në qoftë se ngjarja e rishitjes për mospërmbyshje nuk ndreqet brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga blerësit, njoftim që përmban të dhëna të arsyeshme për ngjarjen e rishitjes për mospërmbyshjen në fjalë dhe (ii) në qoftë se ngjarja e rishitjes për mospërmbyshje në fjalë nuk është shkaktuar menjëherë dhe drejtpërdrejt nga pakujdesia e rëndë ose nga keqsjellja me dashje e blerësve, secili blerës ka të drejtë që, në qoftë se i dorëzon Ministrisë njoftimin e rishitjes brenda periudhës së rishitjes për mospërmbyshje, t'ia rishesë Ministrisë të gjitha (por jo më pak se të gjitha) Aksionet e EBRD-së dhe/ose të gjitha, por jo më pak se të gjitha aksionet e IFC-së, sipas rastit, dhe me ushtrimin nga secili blerës i kësaj të drejte dhe në varësi (i) të së drejtës së Ministrisë për të dërguar në arbitrazh çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Marrëveshje rishitje (përfshirë çdo mosmarrëveshje për faktin nëse ka ndodhur ose jo ngjarja e rishitjes për mospërmbyshje), në përputhje me nenin 14.2; dhe (ii) të dispozitave të nenit 8.1, Ministria do të detyrohet t'i blejë secilit blerës përkatës të gjitha aksionet e EBRD-së dhe/ose të gjitha aksionet e IFC-së, sipas rastit të përcaktuara nga blerësi përkatës ose nga të dy blerësit në njoftimin e rishitjes në datën e dorëzimit me çmimin e rishitjes. Shitja e aksioneve të EBRD-së dhe/ose e aksioneve të IFC-së, sipas rastit, do të përfshijë edhe kalimin në emër të Ministrisë të të gjitha të drejtave të dividendëve të deklaruar përpara datës së pagesës, por që nuk janë marrë ende nga blerësi përkatës në datën e pagesës. Në qoftë se çmimi i rishitjes nuk mund të përcaktohet me saktësi në datën e njoftimit përkatës të rishitjes, blerësi përkatës do t'i paraqesë Ministrisë një njoftim të mëtejshëm të paktën tri (3) ditë-pune para datës së pagesës, duke i dhënë një shifër përfundimtare të çmimit të rishitjes dhe hollësitë e përlllogaritjes.

7. RISHITJA NË DALJE

Kur ndodh një nga ose të gjitha ngjarjet e mëposhtme:

a) Ministria nuk arrin të gjejë dhe të sigurojë miratimin e blerësit brenda një periudhe 24-mujore nga data e transferimit një investitor strategjik do të jetë i pranueshëm nga blerësit për blerjen e të paktën 51% të aksioneve nga Ministria, me kushte të pranueshme nga blerësit (me kusht që blerësit të mos kundërshtojnë një investitor strategjik apo kushte të blerjes vetëm sepse nuk arrijnë të negociojnë kushte të kënaqshme me këtë investitor strategjik potencial për shitjen atij të aksioneve për shitje);

b) çdo vendim i formës së prerë i ndonjë subjekti shtetëror (përfshirë, por pa u kufizuar në,

ndryshimet në ligj), deklaron të pavlefshëm tërësisht ose pjesërisht ndonjë nga veprimet e aktet e mëposhtme:

- i) privatizimin e Shoqërisë ose procedurat përkatëse të privatizimit;
- ii) këtë Marrëveshje rishitje, Marrëveshjen e shitjes së aksioneve (përfshirë blerjen nga EBRD-ja dhe blerjen nga IFC-ja të aksioneve të IFC-së);
- iii) blerjen ose fitimin e interesave fitimprurëse ose të titullit të çdo aksioni; (secila "Ngjarje dalje")

dhe (i) në qoftë se ngjarja e rishitjes për mospërbushje nuk ndreqet brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga blerësit, njoftim që përmban të dhëna të arsyeshme për ngjarjen e rishitjes për mospërbushjen në fjalë dhe (ii) në qoftë se ngjarja e rishitjes për mospërbushje në fjalë nuk është shkaktuar menjëherë dhe drejtpërdrejt nga pakujdesia e rëndë ose nga keqsjellja me dashje e blerësve, secili blerës ka të drejtë që, në qoftë se i dorëzon Ministrisë njoftimin e rishitjes brenda periudhës së rishitjes për mospërbushje, t'i rishesin Ministrisë të gjitha (por jo më pak se të gjitha), aksionet e EBRD-së dhe/ose të gjitha por jo më pak se të gjitha aksionet e IFC-së sipas rastit dhe me ushtrimin nga secili blerës i kësaj të drejte dhe në varësi (i) të së drejtës së Ministrisë për të dërguar në arbitrazh çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Marrëveshje rishitje (përfshirë çdo mosmarrëveshje për faktin nëse ka ndodhur ose jo ngjarja e rishitjes për mospërbushje), në përputhje me nenin 14.2; dhe (ii) të dispozitave të nenit 8.1, Ministria do të detyrohet t'i blejë secilit blerës përkatës të gjitha aksionet e EBRD-së dhe/ose të gjitha aksionet e IFC-së, sipas rastit, të përcaktuara nga blerësi përkatës ose nga të dy blerësit në njoftimin e rishitjes në datën e dorëzimit me çmimin e rishitjes. Shitja e aksioneve të EBRD-së dhe/ose e aksioneve të IFC-së, sipas rastit do të përfshijë dhe kalimin në emër të Ministrisë të të gjitha të drejtave të dividendëve të deklaruar përpara datës së pagesës, por që nuk janë marrë ende nga blerësit përkatës në datën e pagesës. Në qoftë se çmimi i rishitjes nuk mund të përcaktohet me saktësi në datën e njoftimit përkatës të rishitjes, blerësi përkatës do t'i paraqesë Ministrisë njoftim të mëtejshëm të paktën tri (3) ditë-pune para datës së pagesës, duke i dhënë një shifër përfundimtare të çmimit të rishitjes dhe hollësitë e përlogaritjes.

8. KALIMI I AKSIONEVE TË BLERËSVE

8.1 Në datën e pagesës secili prej blerësve që ka ushtruar të drejtat sipas nenit 6 ose nenit 7, i deklaron dhe e garanton Ministrinë, me shkrim, se ka titull të plotë pronësie mbi aksionet që do të transferojë, të gjitha të emetuara në mënyrë të vlefshme dhe të shlyera plotësisht dhe se nuk ka lidhur marrëveshje për aksionet që janë objekt transferimi, të cilat ta kufizonin Ministrinë në ushtrimin e gëzimit të plotë të të drejtave, titujve dhe interesave mbi ato aksione.

8.2 Ministria, në datën e pagesës dhe në vendin e pagesës, do të paguajë çmimin përkatës të rishitjes nga fondet e disponueshme menjëherë në llogarinë bankare që Ministrisë i është njoftuar në njoftimin e vlefshëm të rishitjes dhe do të nënshkruajë të gjitha dokumentet, do të bëjë të gjitha deklaratat dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të blerë të gjithë aksionet e secilit blerës, siç përcaktohet në njoftimin e rishitjes të blerësit përkatës.

8.3 Blerësi përkatës, në datën e pagesës dhe në vendin e pagesës, do të nënshkruajë të gjithë dokumentet, do të bëjë të gjitha deklaratimet dhe në vijim do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për transferimin në favor të Ministrisë të aksioneve të blerësit përkatës, të gjitha të emetuara në mënyrë të vlefshme dhe të shlyera plotësisht.

8.4 Ministria:

a) pranon detyrimet për ta paguar tërësisht çmimin e rishitjes në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje rishitje;

b) pranon se, në rastin e transferimit të aksioneve secilit blerës, detyrimi i saj për të paguar çmimin e rishitjes nuk do të pengohet nga mosregjistrimi i aksioneve të atij blerësi në qendrën e regjistrimit të aksioneve ose nga ndonjë regjistruar tjetër i pavarur dhe as nga ndonjë e metë në formën e ndonjë kalimi ose mospranimi nga qendra e regjistrimit të aksioneve ose ndonjë regjistruar tjetër i pavarur për pranimin e kalimit dhe as nga ndonjë fakt ose rrethanë tjetër, e cila nuk është shkaktuar nga mospërbushja e detyrimeve nga blerësi për këtë kalim, e cila mund ta pengonte Ministrinë të gëzonte plotësisht ose pjesërisht të drejtat që lidhen me aksionet e blerësit;

c) pranon se asnjë veprim ose mosveprim, përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo bashkim, përqendrim, mbyllje, prishje, rindërtim ose riorganizim, kufizim ligjor, paafësi ose mungesë e autoritetit të Shoqërisë dhe asnjë rrethanë tjetër, si ndryshim në themelimin ose identitetin e Shoqërisë

ose humbje e identitetit nga Shoqëria ose ndonjë person tjetër nuk do ta pengojë të përmbushë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje rishitje;

d) pranon se nëse, sipas ligjit të zbatueshëm, do të kërkohet ndonjë autorizim paraprak për kryerjen e shitjes së përcaktuar në njoftimin për rishitjen, Ministria do të shkaktojë lëshimin e këtij autorizimi pa vonesë, në rast se lëshimi i këtij autorizimi është brenda kompetencave të veta ose të ndonjë subjekti shtetëror të cilin Ministria ose ndonjë ministri e Qeverisë shqiptare e ka nën varësi për ta udhëzuar ta lëshojë autorizimin ose, kur lëshimi i autorizimit nuk është në kompetencë të një subjekti shtetëror të tillë, Ministria do të bëjë përpjekje të arsyeshme për lëshimin e autorizimit pa vonesë të paarsyeshme.

8.5 Ministria do të paguajë të gjitha tarifat zyrtare për depozitimin e kërkesave pranë Gjykatës së Tiranës dhe qendrës së regjistrimit të aksioneve për regjistrimin e aksioneve përkatëse në emër të Ministrisë.

9. MOSPËRMBUSHJA NGA MINISTRIA

9.1 Pa nënvlersuar mjetet ligjore për rivendosjen e të drejtave që ka në dispozicion IFC dhe EBRD në bazë të kësaj Marrëveshjeje rishitje, ose kur Ministria nuk kryen asnjë pagesë që i detyrohet secilit blerës në ose përpara datës së përcaktuar në këtë Marrëveshje rishitje ose në ndonjë njoftim të parashikuar këtu, Ministria do t'i paguajë atij blerësi një shumë shtesë në dollarë amerikanë në formë interesi mbi shumën përkatëse të prapambetur, të llogaritur nga data e pagesës, të barabartë me kursin ndërbankar, plus dy për qind (2%) në vit, nga kjo datë deri në datën e pagesës së përbërë siç parashikohet në nenin 9.2.

9.2 Interesi i parashikuar në nenin 9.1 do të llogaritet në bazë të numrit konkret të ditëve që kanë kaluar dhe të vitit me 360 ditë dhe do të llogaritet në fund të çdo periudhe të përbërë.

10. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

10.1 Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje rishitje (me përjashtim të nenit 10.3) ose të çdo dokumenti tjetër të projektit, përgjegjësia e përgjithshme e Ministrisë kundrejt secilit blerës për ose në lidhje me transaksionet e parashikuara në dokumentet e projektit, pavarësisht se si dhe se kur ngrihet kjo përgjegjësi, që përfshin, por pa u kufizuar në (i) pagesën e çmimit të rishitjes dhe (ii) pagesën e çdo dëmi do të kufizohet në (a) koston e blerësit përkatës, plus interesin e barabartë me shumën e kursit ndërbankar (për çdo periudhë të përbërë përkatëse, plus katër pikë pesë për qind (4.5%) në vit nga data e transferimit deri në mbarim të periudhës së rishitjes për mospërmbushje dhe (b) kostot e arsyeshme të dokumentuara dhe shpenzimet e kryera nga secili blerës (përfshirë kostot e arsyeshme të këshilltarit ligjor), në lidhje me procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të kryera sipas dokumenteve të projektit.

10.2 Interesi i përmendur në nenin 10.1 do të përlllogaritet mbi bazën e numrit përkatës të ditëve të kaluara dhe vitit me 360 ditë dhe i përbërë në fund të çdo periudhe të përbërë.

10.3 Në varësi të realizimit të kërkesave të nenit 10.4 dhe të përmbushjes së detyrimeve nga blerësit sipas kushteve të dokumenteve të projektit, Ministria merr përsipër përgjegjësi të plotë dhe pranon të dëmshpërblejë dhe të mbajë secili nga blerësit të padëmtuar kundrejt çdo përgjegjësie, detyrimi, humbjeje, dëmi (të kompensueshëm, të natyrës së gjobës ose tjetër), gjobe, pretendimi, tatimi, takse doganore, padie, kostojë e shpenzimi (përfshirë, pa kufizim, tarifat e arsyeshme të këshilltarit ligjor dhe shpenzimet e kostot e hetimit) të çdo lloji dhe natyre, përfshirë pa u nisur nga trajtimi i përgjithshëm më sipër ato që lindin nga kontrata ose dëmi (përfshirë, pa kufizim, pakujdesinë ose nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë ose nga mënyra të tjera, të cilat janë vendosur ose janë ngritur kundër blerësve nga palët e treta, që nuk kanë lidhje me blerësit dhe që lidhen ose dalin nga (i) shkelja prej Ministrisë e ndonjërit prej dokumenteve të projektit ose (ii) çdo pretendim që mund të ngrejë çdo punonjës ose ish-punonjës i Shoqërisë kundër ndonjërit apo të dy blerësve bashkërisht. Kufizimi i përgjegjësisë i përcaktuar në nenin 10.1 nuk zbatohet në zhdëmtimin e përcaktuar në këtë nen 10.3.

10.4 a) Menjëherë me marrjen nga blerësi, që ka të drejtë dëmshpërblimin sipas nenit 10.3, të njoftimit se një palë e tretë po ngre një pretendim kundër tij, ky blerës, në qoftë se duhet ngritur ankim kundër Ministrisë, njofton Ministrinë për ngritjen e këtij pretendimi.

b) Në qoftë se pretendimi i palës së tretë kundër një blerësi ngrihet me anë të procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit, Ministria ka të drejtë të marrë pjesë në këto procedura dhe në masën që dëshiron të marrë përsipër mbrojtjen në këto procedura me avokat të pranuar nga blerësi përkatës. Pas njoftimit që Ministria i dërgon blerësit përkatës se ka vendosur që të marrë përsipër mbrojtjen në këto procedura, Ministria për aq sa do ta kryejë mbrojtjen në mënyrë të kënaqshme, nuk do të jetë

përgjegjëse para blerësit përkatës për tarifat e avokatit tjetër dhe as për shpezime në lidhje me mbrojtjen në këto procedura, të cilat janë kryer nga blerësi përkatës në lidhje me mbrojtjen në këto procedura. Në qoftë se Ministria merr përsipër mbrojtjen e procedurave, (i) ajo nuk mund të hyjë në kompromis dhe as ta zgjidhë me pajtim mosmarrëveshjen pa marrë pëlqimin paraprak të blerësit përkatës, në qoftë se (A) nuk gjendet ose nuk pranohet ndonjë shkelje e kërkesave ligjore ose ndonjë shkelje e të drejtave të ndonjë personi dhe në qoftë se nuk ka asnjë efekt në ndonjë pretendim tjetër që mund të jetë ngritur kundër blerësit përkatës dhe (B) e vetmja masë është dëmi monetar i paguar plotësisht nga Ministria dhe (ii) Ministria nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë kompromis ose zgjidhje me pajtim të kryer pa pëlqimin e saj.

c) Në qoftë se Ministrisë i është njoftuar fillimi i ndonjë procesi ose procedure dhe Ministria, brenda dhjetë ditëve-pune pas marrjes së njoftimit nga blerësi përkatës, nuk njofton blerësin përkatës nëse do të marrë përsipër mbrojtjen në këto procedura, Ministria do të detyrohet të zbatojë çdo vendim të marrë në këto procedura ose çdo kompromis apo zgjidhje me pajtim të kryer nga blerësi përkatës.

11. PËRSHTATJA

11.1 Në qoftë se kapitali aksionar i Shoqërisë rristrukturohet dhe qëllimi i rristrukturimit është të zvogëlojë shumën e përgjithshme që do të marrin blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje rishitje në kuadrin e ushtrimit të të drejtave të tyre sipas nenit 6 ose 7, kur blerësi të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenin 6 ose 7 çmimi i rishitjes duhet të përshtatet në një mënyrë të tillë që në varësi të kufizimit të përgjegjësisë të përcaktuar në nenin 10.1, blerësi në fjalë të marrë të njëjtën shumë si rezultat i ushtrimit të të drejtave të tij sipas nenit 6 dhe 7, ashtu siç do të kishte bërë sikur rristrukturimi i kapitalit aksionar të mos ishte kryer.

11.2 Në rastin e mosmarrëveshjeve të çfarëdolloj natyre që kanë lidhje me ose që burojnë nga neni 11.1, çështja do t'i paraqitet për zgjidhje një personi të caktuar nga palët ose, kur brenda shtatë ditëve pas njoftimit që njëra palë u bën palëve të tjera dhe kërkesës që u bëhet palëve të tjera për të pranuar një person që zgjidhet me kërkesë të cilësdo palë, palët nuk bien dakord, çështja do t'i paraqitet për zgjidhje presidentit të atëhershëm të Institutit të Ekspertëve Kontabël të autorizuar në Angli dhe Uells. Ky person do të veprojë si ekspert dhe jo si arbitër dhe palët do t'i kërkojnë atij të shprehë vendimin e tij brenda 30 ditëve nga data e caktimit të tij. Duke përjashtuar rastet e ndonjë gabimi, vendimi i tij do të jetë i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët. Kostoja e këtij eksperti do të paguhet nga Shoqëria.

12. TË NDRYSHME

12.1 Kjo Marrëveshje rishitje është detyruese për palët e kësaj Marrëveshjeje rishitje dhe pasardhësit përkatës dhe personat të cilëve u kalojnë të drejtat. Asnjë palë e kësaj Marrëveshjeje rishitje nuk ka të drejtë t'i kalojë këtë Marrëveshje rishitje dhe asnjë të drejtë ose detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin e palës tjetër, përveç kalimit të plotë të saj ose të një pjese të përshtatshme të saj të të drejtave dhe detyrimeve në këtë Marrëveshje rishitje nga njëri blerës tjetrit në lidhje me një kalim të lejueshëm të të gjithë ose të një pjese të aksioneve të blerësit që kalon tek marrësi i tyre.

12.2 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje rishitje, përveç rastit të transferimit ose kalimit të aksioneve nga njëri blerës tek tjetri, çdo kalim ose transferim i aksioneve nga njëri blerës tek tjetri, çdo kalim ose transferim i aksioneve të IFC-së ose i aksioneve të EBRD-së prej secilit blerës do të sjellë mbarimin e të drejtave të atij blerësi (duke përfshirë çdo person që lejohet t'i transferohen ose kalojnë të drejtat në këtë Marrëveshje rishitje) për të ushtruar të drejtat në lidhje me ato aksione të cilat parashikohen në nenin 6 dhe 7.

12.3 Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e ndonjë kompetence ose mjeti ligjor që ka secila palë në këtë Marrëveshje rishitje nuk është heqje dorë prej asaj pale nga ajo e drejtë, kompetencë ose mjet ligjor.

12.4 Asgjë në këtë Marrëveshje rishitje nuk do të konsiderohet se krijon ortakëri midis palëve në këtë Marrëveshje dhe as e bën njërën palë agjente të palës tjetër dhe në një mënyrë tjetër nuk i jep njërës palë autoritetin për të futur në detyrime palën tjetër, për çfarëdolloj qëllimi.

12.5 Kjo Marrëveshje rishitje (së bashku me të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet e nënshkruara njëkohësisht me të ose që referohen në të) përbën marrëveshjen e plotë midis palëve në lidhje me objektin dhe shfuqizon të gjitha marrëveshjet e mëparshme gojore dhe me shkrim në lidhje me këtë objekt dhe asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje rishitje nuk do të hyjë në fuqi pa qenë në formë të shkruar dhe i nënshkruar nga palët ose përfaqësuesit ligjorë të tyre.

12.6 Në rast se ndonjë kusht, dispozitë, term i kësaj Marrëveshjeje rishitje trajtohet si shkelje e

ndonjë ligji të zbatueshëm, statuti ose rregulloreje, ose është i pavlefshëm, ajo do të konsiderohet e fshirë nga kjo Marrëveshje rishitje dhe nuk do të ketë fuqi, ndërsa Marrëveshja e rishitjes do të qëndrojë në fuqi thuajse se kushti, termi ose dispozita nuk kishin qenë të përfshira fare në këtë Marrëveshje rishitje. Pavarësisht nga sa më sipër, në rastin e një fshirjeje të tillë, palët do të negociojnë në mirëbesimin për të rënë dakord për kushtet e dispozitës që do të zëvendësojë dispozitën e fshirë, e cila duhet të jetë e pranueshme dhe e kënaqshme për to.

12.7 Asgjë në këtë Marrëveshje rishitje nuk do të trajtohet si heqje dorë dhe as ndryshim i imunitetit, privilegjeve ose përjashtimeve që EBRD-së i janë dhënë në marrëveshjen e themelimit të Bankës Europiane për Rindërtimin e Zhvillim dhe IFC-së sipas dispozitave të Marrëveshjes së anëtarësisë ose sipas konventave ndërkombëtare ose ligjeve të zbatueshme.

12.8 Të gjitha dokumentet që do të jepen ose komunikimet që do të kryhen sipas kësaj Marrëveshjeje rishitje do të jenë në gjuhën angleze ose, në qoftë se do të jenë në gjuhë tjetër, do të shoqërohen me përkthimin e tyre në anglisht, të vërtetuara nga ana e palës që e jep dokumentin ose bën komunikimin dhe ky përkthim do të jetë versioni ligjor për palët.

12.9 Kjo Marrëveshje rishitje mund të nënshkruhet në disa ekzemplarë ose kopje secila prej të cilave do të jetë origjinale, por këta ekzemplarë ose kopje do të përbëjnë të gjitha së bashku një marrëveshje të plotë dhe të pandarë.

12.10 Koha ka rëndësi thelbësore për qëllimet e çdo dispozite të kësaj Marrëveshjeje rishitje.

13. NJOFTIMET

Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër që do të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje rishitje për çdo palë do të jetë me shkrim. Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë Marrëveshje rishitje, një njoftim i tillë, kërkesë ose komunikim tjetër do të konsiderohet se është dhënë ose bërë kur jepet dorazi, me postë, faks në adresën e palës së përcaktuar më poshtë ose në atë adresë tjetër që njëra palë i njofton palës tjetër që bën njoftimin, kërkesën ose komunikimin:

Për Ministrinë:

Ministria e Financiare e Republikës të Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Në vëmendje të Ministrisë të Financave
Fax: 355 4 228494

Për EBRD-në:

European Bank for Reconstruction and
Development
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom
Attention: Operation Administration Unit
Fax: 44 20 7338 6100

Për IFC-në:

International Finance Corporation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20433 USA
Attention: Director, Global Financial Markets Development
Fax: 1 202 974 4872
CC: Director, Southern Europe and Central Asia Department
Fax: 1 202 974 4849

14. LIGJI QË RREGULLON MARRËVESHJEN DHE ARBITRAZHIN

14.1 Kjo Marrëveshje rishitje do të rregullohet dhe do të interpretohet në të gjitha drejtimet në përputhje me ligjin anglez.

14.2 Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që ngrihet në lidhje me këtë Marrëveshje rishitje ose shkelje, zgjidhje ose pavlefshmëri të saj do të zgjidhet nga arbitrazhi në përputhje me rregullat UNCITRAL të arbitrazhit në fuqi. Arbitrazhi do të përbëhet nga një arbitër i vetëm, i cili emërohet nga Gjykata e Londrës për arbitrazhin ndërkombëtar. Vendi i arbitrazhit do të

jetë Londra, Anglia dhe në të gjitha procedurat e arbitrazhit do të përdoret gjuha angleze. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë që i njeh ligji i arbitrazhit, 1996 ose ndonjë ligj ose akt tjetër nga ankimi kundër çdo vendimi të arbitrazhit dhe nga çdo kërkesë për të kërkuar që gjykata angleze të vendosë rreth një çështjeje ligjore paraprake. Gjykata e Arbitrazhit nuk autorizohet të marrë ose të japë dhe Ministria pranon se nuk do të kërkojë nga asnjë organ gjyqësor marrjen e ndonjë mase provizore mbrojtëse ose vendim paraprak lehtësues kundër blerësve, pavarësisht nga dispozitat e rregullave të arbitrazhit UNCITRAL. Gjykata e Arbitrazhit ka kompetencë të çmojë dhe të përfshijë në proces, vendim ose urdhër çdo mosmarrëveshje të mëtejshme që do t'i paraqitet rregullisht nga secila palë përsa kohë që mosmarrëveshjet lindin nga dokumentet e projektit, por përveç sa më sipër asnjë palë tjetër dhe asnjë mosmarrëveshje tjetër nuk do të përfshihet ose shkrihet me procedurën e arbitrazhit.

14.3 Pavarësisht nga neni 14.2, kjo Marrëveshje rishitje dhe dokumentet e tjera të projektit, si dhe çdo e drejtë e blerësve që buron ose që lidhet me këtë Marrëveshje rishitje apo çdo dokument tjetër projekti, nëse blerësit dëshirojnë, mund që të ekzekutohet nga blerësit në gjykatat e Republikës së Shqipërisë ose në çdo gjykatë tjetër që ka juridiksion. Ministria në favor të blerësve, në mënyrë të parevokueshme, i nënshtrohet juridiksionit joekskluziv të gjykatave angleze në lidhje me çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që lind ose që ka lidhje me këtë Marrëveshje rishitje apo çdo dokument tjetër të projektit, ose shkeljen, zgjidhjen ose pavlefshmërinë e saj.

14.4 Ministria dhe IFC-ja caktojnë, emërojnë dhe autorizojnë, në mënyrë të parevokueshme, personin e përcaktuar në nenin 14.6 për të vepruar si agjent i autorizuar për të marrë njoftimin e thirrjes në gjykatë dhe çdo thirrje tjetër ligjore në Angli për qëllimet e çdo procedure ligjore të nisur në lidhje me këtë Marrëveshje rishitje. Ministria në mënyrë të pakthyeshme jep pëlqimin për marrjen e njoftimeve të procedurave të arbitrazhit ose të çdo thirrjeje ligjore jashtë këtyre gjykatave nëpërmjet njoftimit me postë, letër rekomande në adresën e përcaktuar këtu. Ministria pranon se, për sa kohë që ka detyrime sipas kësaj Marrëveshjeje rishitje, do të mbajë një agjent të përcaktuar për të marrë njoftimin e thirrjes në arbitrazh apo çdo thirrje tjetër ligjore në Angli për qëllime të çdo veprimi ligjor apo procedure të filluar nga blerësit në lidhje me këtë Marrëveshje rishitje dhe do të njoftojë blerësit për identitetin dhe vendndodhjen e këtij agjenti. Asgjë nuk do të cenojë të drejtën e blerësve për të filluar procedurat ligjore kundër Ministrisë me çdo mënyrë të parashikuar me ligjet e çdo juridiksioni përkatës. Fillimi i procedurave ligjore nga blerësit në një apo me shumë juridiksione nuk do të përjashtojë blerësit nga fillimi i procedurave ligjore në çdo juridiksion tjetër në çdo kohë. Ministria, në mënyrë të pakthyeshme, heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose më vonë për vendin e zhvillimit të procedurave ligjore dhe çdo pretendim që mund të ketë tani ose më vonë se procedura ligjore përkatëse është zhvilluar në një forum të papërshtatshëm.

14.5 Nxjerrja e të dhënave

Çdo palë mund të nxjerrë dokumente të tilla, të dhëna dhe regjistrime që kanë lidhje me çdo palë tjetër, si dhe me këtë transaksion (duke përfshirë, pa kufizim, kopje të çdo dokumenti) sipas gjykimit të palës që jep të dhëna në lidhje me çdo mosmarrëveshje që mund të dalë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje me opsion rishitje, me qëllim që të mbrojë apo të zbatojë të drejtat që ka Pala që jep të dhëna në këtë Marrëveshje me opsion rishitje.

14.6 Agjenti i autorizuar për njoftimet:

Për Ministrinë:

Ambasada e Republikës së Shqipërisë

2nd floor

24 Buckingham Gate

London SW1 E 6LB

Për IFC-në:

Korporata Financiare Ndërkombëtare

4, Millbank

London SW1P 3Ja

England

14.7 Asgjë në këtë Marrëveshje rishitje nuk synon t'u japë ndonjë të drejtë personave që nuk janë palë dhe ligji i vitit 1999 për kontratat (për të drejtat e palëve të treta) nuk zbatohet në këtë Marrëveshje rishitje.

Me dëshmi të dëshmitarëve përkatës, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të

autorizuar, hartuan këtë Marrëveshje rishitje për t'u nënshkruar nën emrat e tyre respektivë sipas datës së parë si më sipër të shënuar.